



**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PROFESIONAL – TEKNIK (APT)**

PROGRAMI I LËNDËS

HISTORI
Klasa e 11- të

STRUKTURA e APT: 2+1+1, bllok 4 vite

DREJTIMET e APT: Për të gjitha drejtimet

Koordinatori: EVIS MASTORI

Redaktori: GAZMEND KRASNIQI

Përgjegjës sektori: MARITA HAMZA

TIRANË, KORRIK 2010

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, studion tërë aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore, si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke vendosur një raport të barabartë midis këtyre fushave të jetës. Përvoja njerëzore, e vendosur nga programi në një kornizë historike tematike, nuk paraqitet e kufizuar vetëm në një aspekt të jetës, si në programet e mëparshme, por trajton probleme që lidhen me qytetërimin, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme, pra nga mënyra e jetesës, e deri te sistemet ekonomike, politike e kulturore.

Historia e qytetërimit botëror ka për qëllim, përgatitjen e nxënësve për të qenë qytetarë të informuar të botës, të aftë për të ndërvepruar me individ dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, si dhe të aftë për të kuptuar të kaluarën, të sotmen dhe perspektivat e së ardhmes.

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, që zhvillohet në klasat 10 dhe 11-të, trajton ngjarjet historike në vazhdimësi kronologjike, e cila mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror.

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, shpreh risi për problematikën që ai sjell dhe mënyrën e trajtimit, në krahasim me kurrikulën e mëparshme të arsimit të mesëm. Ai synon që të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike e historisë së qytetërimit botëror, shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë së qytetërimit botëror, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh dhe vendosjen e një balance historike mes kontributeve të shoqërive në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit botëror, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t’i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes. Programi shpalos hapësira që i japin mundësi nxënësit për t’u përfshirë në ato fusha ku ai dëshiron të thellohet.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda “Historia e qytetërimit botëror” synon:

- Të aftësojë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike.
- Të zhvillojë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur sidomos për çështjet të ndjeshme historike.
- Të aftësojë nxënësit për t’u bërë qytetarë aktiv dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale duke ju mundësuar atyre të ndërtojnë

identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët.

- Të ngrejë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja:

- Të përshkruajë momentet më kulmore të zhvillimit të shoqërisë, nëpërmjet një trajtimi kronologjik tematik.
- Të përshkruajë përvojën historike të shoqërisë, për të kuptuar më mirë nxënësit jetën aktuale dhe për të qenë të aftë të projektojnë të ardhmen, duke nxitur tek ata të menduarin në mënyrë kritike.
- Të interpretojë shoqërinë njerëzore në të kaluarën, për të kuptuar nxënësit të sotmen dhe ndikimin e tyre në zhvillimet historike të së ardhmes.
- Të zhvillojë aftësitë për të kuptuar perspektivat e ndryshimeve historike, në një botë në ndryshim.
- Të interpretojë efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes.
- Të edukohet me ndenjë e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë.
- Të argumentojë vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.
- Të vlerësojë pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- Të forcojë ndenjë e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.
- Të kryejë punë kërkimore, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- Të edukohet me frymën argumentuese përballë tezave të ndryshme rreth një fenomeni historik.
- Të tregojë lidhjen e vlerave pozitive si: toleranca dhe respektimi i dallimeve ndërmjet kulturave të ndryshme, përmes studimit të historisë.
- Të zhvillojë, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre për në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Të përcaktojë detyrimet dhe përgjegjësitë në kuadrin e shtetit ligjor, të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të individit, nëpërmjet pajisjes me kulturë të plotë demokratike.

3. OBJEKTIVA

a) Linja: Qytetërimet në fillimet e historisë moderne

Përshkrimi i linjës:

Kjo linjë prezanton kthesën e madhe që mori qytetërimi botëror pas Rilindjes Evropiane dhe Zbulimeve të Mëdha Gjeografike. Përmes kësaj linje, nxënës/i-ja do të kuptojë ndryshimet

rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare, të cilat sollën fillimin e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor.

Orë të sugjeruara¹: 6

Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar ²	Objektiva
Ndryshimet në qytetërimet botërore	<p>Humanizmi dhe Rilindja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Thelbi i Humanizmit. ▪ Rilindja, fryma e saj në art, kulturë, shkencë e në shoqëri. 	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: Humanizëm, Rilindje; ▪ të përcaktojë tiparet e Humanizmit; ▪ të evidentojë kushtet historike që çuan në periudhën e Rilindjes evropiane; ▪ të analizojë ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë.
	<p>Evropa drejt njohjes së “Botës së re”:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rrethanat e favorshme tekniko-shkencore dhe ekonomiko-politike nxisin zbulimet gjeografike. ▪ Në kërkim të rrugëve të reja: <ul style="list-style-type: none"> - zbulimet e mëdha gjeografike. - kultura dhe shoqëria vendase (acteke, inke). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptin historik “Bota e Re”; ▪ të analizojë rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”; ▪ të përcaktojë në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të “Botës së Re”; ▪ të vlerësojë kulturën e popujve të “Botës së Re”.

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës.

² Përmbajtjet e sugjeruara janë çështje mësimore të rekomanduara nga specialistët, për të orientuar hartuesit e tekstit të lëndës, në zbatimin e objektivave lëndorë. Ato nuk përfaqësojnë një njësi ore mësimore. Quhen të sugjeruara, pasi hartuesit e tekstit mund të zvogëlojnë ose të zgjerojnë hapësirën e çështjeve mësimore të sugjeruara, por ata duhet të zbatojnë me rreptësi përmbajtjen e objektivave të nënlinjave.

	<p><i>Ndryshimet fetare në Evropë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rrënjët e Reformacionit, doktrina protestante, përfaqësuesit kryesorë. ▪ Kundërreforma katolike dhe karakteri relativ i saj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: reformacion, kundërreformacion; ▪ të përcaktojë faktorët që sollën përçarjen në besimin katolik; ▪ të analizojë idetë kryesore të Luterit dhe Kalvinit, duke treguar veçoritë e pikëpamjeve të tyre; ▪ të shpjegojë veçoritë e Reformacionit në Angli; ▪ të analizojë pasojat e Reformacionit protestant në Evropë; ▪ të shpjegojë përmbajtjen dhe karakterin e Koncilit të Trentos;
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara²:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndikimi i qytetërimeve të lashta në Rilindjen evropiane. ▪ Ndikimi i Rilindjes evropiane te shqiptarët. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të gjykojë për ndikimin e qytetërimeve të lashta në Rilindjen evropiane; ▪ të analizojë ndikimin e Rilindjes evropiane te shqiptarët; ▪ të evidentojë humanistët shqiptarë si Marlin Barleti, Pal Engjëlli, Mikel Maruli.

b) Linja : Koha e ndryshimeve thelbësore

Përshkrimi i linjës:

Kjo linjë ka për qëllim të pasqyrojë ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin perëndimor dhe botëror. Linja përfshin lindjen e nacionalizmit i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale ne Evropën Qendrore dhe Ballkan. Gjithashtu linja trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike.

Orë të sugjeruara: 12

² Veprimtari praktike të sugjeruara janë orë praktike në funksion të përpunimit dhe thellimit të njohurive të reja, si dhe të aftësisimit praktik të nxënësve. Janë të sugjeruara, sepse përdoruesit e programit (hartuesit e tekstit dhe mësuesit) mund t'i ndryshojnë këto veprimtari të sugjeruara, në funksion të nevojave të përpunimit të lëndës dhe të përshtatjes së këtyre veprimtarive me ngjarjet e reja në kohë. Përdoruesit e programit mund të përzgjedhin ato veprimtari që i mendojnë më të përshtatshme, për përpunimin e objektivave të linjës dhe të nënlinjës.



Nën linja	Përmbajtje e sugjeruar	Objektiva
<p>Ndryshimet në kulturën politike dhe ekonominë Evropiane.</p>	<p><i>Kultura politike dhe shtetet moderne :</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Absolutizmi në Francë. ▪ Iluminizmi. 	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: merkantilizëm, kapitalizëm, kolonializëm, iluminizëm; ▪ të analizojë tiparet e qeverisjes në Francë duke evidentuar absolutizmin e Luigjit XIV; ▪ të përcaktojë idetë e iluministëve dhe ndikimin e tyre në ndryshimet e jetës së qytetërimeve botërore.
	<p><i>Zhvendosja e tregut botëror nga Mesdheu drejt Atlantikut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ (Ekonomia atlantike: shkëmbimet tregtare midis Evropës dhe “Botës së Re; Merkantilizmi, kapitalizmi, komunikacioni; Krijimi i kolonive): 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë ndryshimet, që sollën zbulimet gjeografike në ekonomi dhe në shkencë; ▪ të analizojë pasojat ekonomike (ku përfshihet roli i teorisë tregtare merkantiliste), revolucionin tregtar dhe kapitalizmin në fillimet e tij; ▪ të gjykojë për shkaqet e zhvendosjes së tregut botëror; ▪ të përshkruajë kulturat e reja bujqësore që u këmbyen ndërmjet midis Evropës dhe “Botës së re” pas zbulimeve gjeografike; ▪ të argumentojë lidhjen midis zbulimeve gjeografike dhe procesit të kolonializmit; ▪ të përshkruajë kolonializmin si parakusht i krijimit të perandorive botërore.

<p>Revolucionet dhe ideologjitë e reja</p>	<p><i>Revolucionet, në Angli, Amerikë e Francë):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Revolucioni anglez: shkaqet e fillimit, etapat, Revolucioni i Lavdishëm, triumfi i parlamentarizmit. ▪ Revolucioni amerikan: pavarësia e kolonive angleze në Amerikën e Veriut, konflikti i 13 kolonive angleze me Anglinë, shpallja e Kushtetutës amerikane, lufta civile. ▪ Revolucioni francez, fazat e tij, Deklarata mbi të “Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit”, periudha Napoloniane e Francës, Evropa pas rënies së tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe: revolucion, hop, zhvillim i vrullshëm, luftë civile, protektorat, restaurim, kompromis, kushtetutë, liri, barazi, vëllazëri; ▪ të përkufizojë konceptet revolucion politik, revolucion social, revolucion industrial; ▪ të përshkruajë fazat e revolucionit anglez, duke argumentuar evolucionin politik të tij; ▪ të analizojë përmbajtjen, karakterin dhe vlerat e Aktit mbi të Drejtat e Njeriut; ▪ të shpjegojë tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli; ▪ të shpjegojë shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; ▪ të evidentojë rolin dhe vlerat e Deklaratës së Pavarësisë të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; ▪ të vlerësojë kushtetutën amerikane, duke gjykuar për risitë që ajo solli lidhur me organizimin shtetëror, në qytetërimin botëror; ▪ të analizojë shkaqet e luftës civile, duke nxjerrë përfundime për rrjedhojat e saj; ▪ të analizojë shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; ▪ të evidentojë fazat e Revolucionit francez; ▪ të shpjegojë vlerat e Deklaratës mbi të “Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit” , si bazë e demokracisë liberale në Francë; ▪ të analizojë idetë e reja të revolucionit francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror; ▪ të vlerësojë rolin që luajtën revolucionet (anglez, amerikan, francez) dhe ndikimet që ato sollën në mendimin politik global; ▪ të shpjegojë faktorët e ardhjes në pushtet të Napolonit; ▪ të përcaktojë në hartë fazat e zgjerimit të territorit francez në periudhën e Napolonit; ▪ të evidentojë ndryshimet politike që pësoi Evropa pas rënies së Napolonit.
---	---	---

	<p><i>Industrializimi dhe qytetërimi botëror:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillimet e shkencës - paraprijëse të revolucioneve industriale; Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial; Ndryshimet që sollën revolucionet në ekonomi dhe në mënyrën e jetesës. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë faktorët që paraprinë Revolucionin e Parë Industrial; ▪ të shpjegojë ecurinë e Revolucionit të Parë Industrial dhe rrjedhojat sociale të tij; ▪ të argumentojë lidhjen e Revolucionit të Dytë industrial me zhvillimin e industrisë dhe urbanizimit; ▪ të krahasojë shkaqet dhe rrjedhojat e Revolucionit të Parë Industrial kundrejt Revolucionit të Dytë Industrial, duke evidentuar ndikimet që ato patën në jetën ekonomike e sociale të qytetërimeve botërore.
	<p><i>Ideologjitë e reja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Romantizmi nacionalizmi dhe liberalizmi. ▪ Lëvizjet kombëtare në Evropë dhe fillesat e Demokracisë liberale (Angli, SHBA, Gjermani). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: romantizëm, nacionalizëm, komb-shtet, liberalizëm; ▪ të shpjegojë ndikimin e iluminizmit dhe të romantizmit në lindjen e nacionalizmit; ▪ të përshkruajë nacionalizmin si ideologji të shek. XIX dhe ndikimin e tij në lëvizjet kombëtare në Evropë; ▪ të përcaktojë karakterin e nacionalizmit të popujve të Perandorisë Hasburgase e të asaj Osmane (Ballkan) dhe të shteteve gjermane; ▪ të paraqesë skematikisht hartën e re të Ballkanit, duke përcaktuar në të shtetet e reja të krijuara në shek. XIX – XX. (Serbia, Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Shqipëria) ▪ të evidentojë lëvizjen qytetare për të drejtën elektorale, çështjet punëtore dhe institucionalizimin e partive politike si fillesa të demokracisë liberale. ▪ të shpjegojë reformat sociale të Bismarkut në Gjermani, si fillesë e shtetit të mirëqenies sociale.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Monarkët gjermanë në Ballkan 1830 – 1876. (Në Greqi, Bullgari, Rumani). ▪ Progresi i burimeve energjetike, thelb i revolucioneve industriale. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë arsyet e vendosjes së monarkëve gjermanë në Ballkan; ▪ të analizojë progresin e zhvillimeve teknologjike, duke evidentuar kalimin nga një burim energjetik në një burim energjetik më të avancuar.

c) Linja: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

Përshkrimi i linjës:

Në këtë linjë trajtohen tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nëpërmjet kësaj linje, nxënës/i-ja do të kuptojë, analizojë dhe gjykojë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Ai/ajo do të identifikojë frontet e luftës dhe do të vlerësojë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Kjo linjë trajton përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijon te ata bindjen se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje më të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Linja krijon një tablo të qartë për drejtimet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë dy sistemeve (demokratike dhe totalitare).

Orë të sugjeruara : 8

Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar	Objektiva
<p>Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920)</p>	<p><i>Lufta e Parë Botërore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i blloqeve politike ushtarake evropiane, shkaqet dhe preteksti për fillimin e luftës, fillimi i Luftës së Parë Botërore, veprimet kryesore luftarake gjatë luftës, përfundimi i luftës, Konferenca e Paqes, karakteri dhe vendimet. 	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore ▪ të përcaktojë në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore; ▪ të shpjegojë shkaqet dhe rrjedhojat e revolucionit të vitit 1917 në Rusi; ▪ të përshkruajë karakterin dhe vlerat e planit amerikan për paqen në botë (14 pikat e Willsonit); ▪ të analizojë disa nga vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes së arritur në Versajë; ▪ të pasqyrojë hartën e re politike të Evropës pas Luftës së Parë Botërore. ▪ të gjykojë pasojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj.
	<p><i>Veprimtari praktike e sugjeruar:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 14 pikat e Willsonit dhe paqja e brishtë në Evropë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë 14 pikat e Willsonit, duke i krahasuar me vendimet e Konferencës së Paqes.

<p>Qytetërimet midis dy Luftërave Botërore.</p>	<p><i>Sistemet politike në periudhën midis dy luftërave botërore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Diktaturat e majta dhe të djathta. ▪ BRSS nën Stalinin. ▪ Fashizmi në Itali. ▪ Rënia e Republikës Demokratike të Vajmarit dhe ardhja në pushtet e nazistëve në Gjermani. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë konceptet historike kyçe: demokraci, komunizëm, fashizëm, antisemitizmi, nazizëm, imperializëm, social-demokraci, racizëm, proteksionizëm, ekonomi socialiste, krizë ekonomike, shoqëri civile, diktaturë, diktatura e proletariatit, lufta e klasave; ▪ të përcaktojë sistemet kryesore politike në vitet 1920 – 1939; ▪ të analizojë shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverive totalitare në Bashkimin Sovjetik, në Gjermani dhe në Itali; ▪ të analizojë tiparet e sistemeve totalitare të majta dhe të djathta, duke bërë dallimet midis tyre; ▪ të analizojë politikën e Stalinit si pika kulmore e zbatimit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave; ▪ të përshkruajë kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit; ▪ të shpjegojë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; ▪ të përshkruajë kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; ▪ të shpjegojë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; ▪ të gjykojë rolin e liderëve politikë në rrjedhën e ngjarjeve historike të kohës, si, p.sh.: (Hitleri, Lenini, Rusvelti, Stalini, Musolini).
--	--	--

	<p><i>Ekonomia në periudhën midis dy Luftërave Botërore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sistemet ekonomike, kriza e madhe ekonomike, tiparet dhe rrjedhjat e saj, politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë problemet ekonomike pas Luftës së Parë Botërore; ▪ të krahasojë tiparet e sistemit ekonomik kapitalist me ato të sistemit socialist, duke evidentuar industrializimin si tipar të përbashkët të tyre; ▪ të analizojë shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - stoqet në tregje, - falimentimin e bankave, - papunësinë; ▪ të analizojë pasojat e krizës ekonomike në periudhën midis dy luftërave; ▪ të shpjegojë politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike: <ul style="list-style-type: none"> - Shteti i mirëqenies në Angli, - Fronti Popullor në Francë, - Marrëveshja e re (Kursi i ri i Rusveltit) në SHBA; ▪ të gjykojë arsyet e militarizimit të ekonomisë.
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rruga e Turqisë drejt evropianizimit - reformat e Atatürkut. ▪ Përhapja e ideve komuniste në Evropë. ▪ Jetë paralele: Rruga drejt kultit të individit (Stalini dhe Hitleri). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të mbledhë të dhëna për shndërrimin e Turqisë në një shtet të evropianizuar, duke gjykuar për rolin e reformave të Atatürkut në këtë proces; ▪ të tregojë rolin që luajti Internacionalja e Tretë Komuniste në përhapjen e komunizmit në botë; ▪ të analizojë format e përdorura nga diktatorët për ngritjen e kultit të tyre të individit, duke krahasuar Hitlerin me Stalinin.
<p>Lufta e Dytë Botërore(1939-1945)</p>	<p><i>Lufta e Dytë Botërore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, karakteri i saj, frontet kryesore, përfundimi i luftës, trashëgimia e Luftës së Dytë Botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; ▪ të përcaktojë në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; ▪ të shpjegojë rolin e grupeve të rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore. ▪ të analizojë pasojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Dytë Botërore.

	<p><i>Veprimtari praktike e sugjeruar:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të hulumtojnë për kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e popullsisë hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore.
--	--	---


d) Linja: Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)

Përshkrimi i linjës:

Përmes kësaj linje, nxënësit njihen me shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë, arsyen e ndarjes së botës në dy blloqe dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore. Kjo linjë përshkruan ecurinë e zhvillimeve të mëvonshme ekonomike e njohur si “mrekullia ekonomike” apo “ vitet e arta” gjatë së cilës u realizua kalimi në shoqërinë postindustriale dhe triumfoi shteti i mirëqenies sociale. Në këtë linjë nxënësit do të prezantohen dhe me prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme.

Orë të sugjeruara: 8

Nënlinja	Përmbajtje e sugjeruar	Objektiva
<p>Qytetërimi botëror në periudhën (1945-1990)</p>	<p><i>Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konferenca e Paqes, ndryshime dhe ngjashmëri me traktatin e Versajës, krijimi i OKB-së, arsytet dhe qëllimi i saj. 	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe: Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, superfuqi, bllok, detantë, dekolonizim, bashkekzistencë paqësore, denazistifikim, çmilitarizim, komitete për të drejtat e njeriut, armë bërthamore, garë armatimesh, ekonomi mikse , globalizëm, hipi; ▪ të analizojë kushtet historike të krijimit, karakterin dhe qëllimet e OKB-së. ▪ të tregojë kushtet historike dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Paqes, duke analizuar vendimet kryesore të saj dhe ndryshimet që ato sollën në botën e pasluftës; ▪ të analizojë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis Konferencës së Paqes pas Luftës së Parë Botërore dhe asaj të pas Luftës së Dytë Botërore.



	<p>Lufta e Ftohtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fillimi i Luftës së Ftohtë, krijimi i dy superfuqive (ShBA dhe BRSS); Organizimi i bllokut perëndimor dhe i bllokut komunist, prirjet e zhvillimit politiko-ekonomik, integrimi ekonomik dhe politiko-ushtarak i shteteve brenda bllokut perëndimor dhe atij komunist. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë fillimet e Luftës së Ftohtë, duke analizuar shkaqet dhe pasojat e krijimit të dy blloqeve; ▪ të analizojë veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të dy superfuqive; ▪ të përshkruajë tiparet e përbashkëta të organizimit ekonomik-politik të shteteve të bllokut perëndimor; ▪ të shpjegojë arsyet dhe rrugët drejt integritit ekonomik dhe politiko - ushtarak të shteteve të bllokut perëndimor (Komuniteti Evropian i Çelikut dhe i Qymyrit, Komuniteti Ekonomik Evropian, NATO); ▪ të shpjegojë rrugët e vendosjes së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore; ▪ të përshkruajë tiparet e përbashkëta të organizimit ekonomik-politik të shteteve të bllokut komunist; ▪ të shpjegojë arsyet që çuan drejt integritit ekonomik dhe politiko-ushtarak të shteteve të bllokut komunist (KNER-i dhe Traktati i Varshavës);
	<p>Ekonomia:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rindërtimi ekonomik i Evropës pas Luftës së Dytë Botërore; Veçoritë e ekonomisë në shtetet e bllokut komunist dhe perëndimor; Revolucioni i Tretë Industrial, ndikimi i tij në zhvillimet ekonomike e shoqërore botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të vlerësojë rolin e programit të UNRRA-s dhe të Planit Marshall në rimëkëmbjen ekonomike të Evropës perëndimore; ▪ të analizojë karakteristikat e ekonomisë pas luftës; ▪ të evidentojë arsyet e bumit ekonomik në shtetet e bllokut perëndimor, duke e krahasuar me zhvillimin ekonomik në bllokun komunist; ▪ të përshkruajë prirjet e revolucionit të tretë industrial (elektronik); ▪ të analizojë ndikimin që pati Revolucioni i Tretë Industrial në perspektivën ekonomike shoqërore të botës.

	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Izolimi i Shqipërisë. ▪ Gjallërimi i të rinjve-kërkesat e studentëve për hapësira të reja. ▪ Konferenca e Helsinkit dhe të drejtat e njeriut. ▪ Jetë paralele: Dy modele udhëheqësish Kenedi-Hrushovi. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të diskutojë për shkaqet dhe pasojat e vetizolimit të Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë; ▪ të mbledhë të dhëna për karakterin e lëvizjeve studentore në vitin 1968 në Evropën Perëndimore dhe të diskutojë në klasë rreth tyre; ▪ të vlerësojë rolin e Konferencës së Helsinkit në promovimin dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut; ▪ të mbledhë të dhëna dhe të diskutojë për veprimtarinë politike të brendshme dhe të jashtme të Kenedit dhe të Hrushovit.
<p>Fitorja e demokracisë</p>	<p><i>Përfundimi i Luftës së Ftohtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shembja e murit të Berlinit dhe revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore; Ndryshimet e hartës politike të Evropës në përfundim të Luftës së Ftohtë; Shtetet ish-komuniste në periudhën e tranzicionit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përdorë saktë termat dhe konceptet historike kyçe: revolucion demokratik, “glasnost”, “perestrojkë”, tranzicion për në demokraci, integrim, zgjerim i BE-së, integrim rajonal, grup etnik, konflikt etnik; ▪ të përshkruajë ngjarjet që shënuan përfundimin e Luftës së Ftohtë; ▪ të analizojë shkaqet e dështimit të sistemeve komuniste në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore; ▪ të evidentojë në hartën politike të Evropës, ndryshimet territoriale të pas Luftës së Ftohtë; ▪ të analizojë shkaqet dhe rrjedhimet e ndryshimeve territoriale në Evropë: Bashkimi i Gjermanive, shpërbërja e BS-së dhe e Jugosllavisë, duke evidentuar si përfundim të procesit pavarësinë e Kosovës.
	<p><i>Bashkimi Evropian:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Hapat e mëtejshëm drejt integritimit evropian; Zgjerimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të evidentojë Traktatin e Mahstritit, si vazhdues të procesit të integritimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian; ▪ të listojë në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, duke evidentuar misionin e tyre; ▪ të analizojë zgjerimin e procesit të integritimit euro-atlantik në shtetet ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore; ▪ të analizojë integritimin rajonal, si proces ndihmës i integritimit evropian.

	<p><i>Prirjet e qytetërimeve sot:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Jeta e përditshme në qytetërimet e sotme; Globalizmi, uniformiteti; Prirjet e mëtejshme të zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përshkruajë format dhe mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot; ▪ të analizojë arsyet e rritjes së rolit të gruas në jetën shoqërore dhe politike sot; ▪ të përcaktojë elementet e globalizmit, duke analizuar ndikimin e tyre në perspektivën e shoqërisë globale; ▪ të evidentojë tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit; ▪ të evidentojë prirjet e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës;
	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqipëria drejt integritimit euro-atlantik. ▪ Evropa e Bashkuar dhe identiteti kombëtar. ▪ Republika e Pavarur e Kosovës- një e drejtë e mohuar për një popullsi në shumicë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përgatisë punime për përpjekjet e Shqipërisë drejt integritimit euro-atlantik ▪ të shkruajë ese për temën “Evropa e Bashkuar dhe identiteti kombëtar” dhe të diskutojë e të debatojë për të në klasë; ▪ të përshkruajë rrugën e zhvillimit historik që ka përshkuar Kosova drejt Pavarësisë;



4. KËRKESA TË HISTORISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

HISTORI	MATEMATIKË
Për të gjitha linjat e nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të ndërtojë dhe interpretojë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike. (p. sh., vendosja në tabelë e të dhënave statistikore të dëmeve njerëzore gjatë Luftës së Dytë Botërore të vendeve të Evropës. Hedhja e tabelës në grafikë dhe interpretimi i saj.)
HISTORI	GJUHË SHQIPE
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik; të shprehë opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate tërheqëse dhe argumentuese me tematikë historike; të shkruajë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese me tematikë historike; të përzgjedhë informacionin e duhur historik në një vëllim të caktuar; të shfrytëzojë teknikën e duhur gjuhësore, për të shkruar një artikull historik; të shfrytëzojë rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik; të lexojë dhe të interpretojë burime të ndryshme historike në dialektet gjuhësore.
HISTORI	LETËRSI
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik. P. sh., nëpërmjet veprës së Homerit, njihet me organizimin shoqëror të jetës në antikitet. “Qytetërimi antik grek në veprën e Homerit”. të përdorë folklorin shqiptar si burim historik; të përdorë veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë. “Rilindësit-prodhim i epokës historike shqiptare”.
HISTORI	GJUHË E HUAJ
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë gjuhën e huaj si burim për interpretimin në gjuhën shqipe të një informacioni historik. (p. sh., nxënësit në një veprimtari praktike i kërkohet të gjejë informacion me temë “Perandor romak me origjinë

	<p>ilire”, duke shfrytëzuar si mjet burimor internetin.);</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë terminologjinë bazë historike në gjuhë të huaj. <p>Terminologjia bazë e historisë që i kërkohet anglishtes: History; civilization; state, nation; law; absolute monarchy; constitution; war; king; queen; time; place; religion; government; evidence; World War I/II; empire; expirer; ancient; BC (before Christ); AC (after Christ); medieval; century.</p>
HISTORI	TIK
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter. të përdorë word-processor-in për shkrimin e një materiali historik. të përdorë Power Point-in për prezantimin e një detyre në histori. të ndërtojë tabela, grafikë e diagrame në kompjuter, për të paraqitur me anë të tyre të dhëna të ndryshme historike. (p. sh., vendosja në tabela, diagrame e grafikë e të dhënave statistikore materiale dhe njerëzore të vendeve të Evropës për periudhën e Luftës së Dytë Botërore); të përdorë internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe figura historike.
HISTORI	GJEOGRAFI
Për të gjitha nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë mjetet mësimore gjeografike si harta, globi dhe busulla për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike; të lexojë dhe të interpretojë harta të ndryshme historike dhe gjeografike; të orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike; të përcaktojë në hartë vendndodhjen e qytetërimeve. Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve; të përshkruajë teorinë e formimit të Tokës, për të argumentuar tezën e formimit të Tokës nga pikëpamja shkencore; të përkufizojë dhe të shpjegojë termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërime, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.

HISTORI	QYTETARIA
Për të gjitha nënlinjat	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të përkufizojë dhe shpjegojë konceptet liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve; • të analizojë dhe interpretojë organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike; • të shpjegojë dhe analizojë format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike; • të analizojë dhe interpretojë besimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare në lëndën “Historia e qytetërimit botëror”.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë, çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh., le të marrim te “Historia e qytetërimit botëror” klasa e 11-të, objektivin:

Nxënës/i-ja duhet të jetë i/e aftë “të ndërtojë linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike”. Ky objektivi do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia të ushtrohen për ndërtimin e linjës së kohës dhe për vendosjen në këtë linjë të periudhave historike.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh., le të marrim te “Historia e qytetërimit botëror” klasa e 11-të, objektivin:

Nxënës/i-ja duhet të jetë i/e aftë “të përdorë një gjerësi burimesh historike dhe informacioni të duhur, duke përfshirë dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, medie, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë dhe internetin si bazë hetimi vetjak, për ndërtimin dhe argumentimin e një ngjarjeje historike”.

Të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të përdorin burimet historike dhe ato të informacionit, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të

këtij koncepti historik. Një nivel arritjeje është grumbullimi, përzgjedhja dhe kuptimi i materialit historik. Një nivel më i lartë se ky është interpretimi i këtij materiali historik në kontekstin e njohurive të mara. Një nivel edhe më i lartë do të ishte gjykimi për të, duke mbajtur qëndrim personal, bazuar në argumente dhe duke parashikuar perspektivat e së ardhmes.

Orët mësimore

Programi i historisë së qytetërimit botëror, në klasën e 11-të të shkollave të mesme profesionale, drejtimi: Veterinari, trajton “Historinë e Qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore”, që zhvillohet në **34 orë mësimore vjetore (34 javë x 1 orë mësimore/javë)**, prej të cilave **70% njohuri të reja kundrejt 30% përpunim njohurish** (përsëritje, testim, veprimtari praktike, projekte kurrikulare, etj). Programi ka natyrë tematike-kronologjike dhe është strukturuar në linja dhe nënlinja, që vijjnë njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera historike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zberthimin e këtyre tematikave (linjave) në kapituj (nënlinja).

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t’u ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit. Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohet historia e qytetërimit të popullit shqiptar me historinë e qytetërimit botëror, duke inkuadruar ngjarjet e historisë së popullit shqiptar në ngjarjet e historisë botërore, nëpërmjet periodizimit të historisë.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës; ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të nënlinjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga

ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si: forcimi i personalitetit, edukimi i karrierës, aftësia për të vendosur në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike, aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak–pasojë, aftësia për të hetuar, interpretuar dhe parashikuar ngjarje historike, aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit, nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi i historisë vlerëson me notë apo me stimul shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Mësuesi, gjithashtu, vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një ese-je, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje apo figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga mini- testet pak minutëshe për një objektiv të veçantë të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar vlerësimin me shkrim ose me gojë.